




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

UDHËZUES PËR NXËNËSIT
(MATURANTËT) PËR PARAQITJE E
PROVIMIT SHTETËROR TË MATURËS NË
PLATFORMËN eKOSOVA

REGJISTRIMI NË SISTEMIN EKOSOVA


Kyçu në adresën <https://ekosova.rks-gov.net/> dhe në shfletuesin tuaj të internetit do të shfaqen pamjet vijuese:



Duhet që të klikoni në butonin



dhe pastaj hapet pamja vijuese:




HAPAT QË DUHET NDJEKUR NGA NXËNËSIT (MATURANTËT) PËR PARAQITJE TË PROVIMIT SHTETËROR TË MATURËS

Pasi keni krijuar llogarinë në eKosova, paraqitja e provimit shtetëror të maturës realizohet duke hyrë me llogari përmes numrit tuaj personal dhe fjalëkalimit që e keni krijuar.


Hapat e përdorimit:

- 1 . Vegza për qasjen në sistem: <https://ekosovams.rks-gov.net/>
- 2 . Në ekran shfaqet mënyra e qasjes në sistem si në foton [Fig.1.0].
- 3 . Pasi të jetë hapur dritarja, fushat “Përdoruesi” dhe “Fjalëkalimi” duhet të plotësohen me të dhëna nga përdoruesi i cili ka qasje në sistem.
- 4 . Pas përfundimit duke klikuar butonin “Hyr”, nëse të dhënat e përdoruesit janë të sakta, në ekran hapet faqja e parë, pas identifikimit të suksesshëm shfaqen mundësitë e menaxhimit të platformës që i përkasin përdoruesit [Fig. 1.1].

Ilustrimet:





[Fig.1.0]



[Fig.1.1]

Vazhdoni të klikoni te ikona [> Shërbime](#) [>](#), mandej vazhdoni të klikoni në ikonën


Arsimi, dhe klikoni në **Apliko për paraqitje të provimit të maturës** në dritaren e shfaqur.



[Fig.1.2]

Shfaqja e tabelës ku nxënësi (maturanti) duhet t’i plotësojë të dhënat e kërkuara.

Apliko për paraqitje të provimit të maturës

Komuna: Zgjedhni një opsion

Shkolla: Zgjedhni një opsion

Drejtimi: Zgjedhni një opsion

Lënda zgjedhore: Zgjedhni një opsion

Paralelja: 12/

Numri në ditari: Numri në ditari

Viti i diplomimit: Viti i diplomimit:

Gjuha që dëshironi të jetë testi: Shqip

Apliko

[fig. 1.3]

Fushat e sipërme pasqyrojnë:

Komuna: duhet zgjedhur komuna ku keni kryer shkollimin tuaj

Shkolla: duhet zgjedhur shkolla ku keni kryer shkollimin tuaj

Drejtimi: zgjedh drejtimin e shkollimit tuaj

Lënda zgjedhore: duhet zgjedhur 1 nga 12 lëndët që gjenden në listën rënëse

Paralelja: paralelja e juaj që keni qenë nxënës (maturant)


Numri në ditari: numri i juaj i ditarit

Viti i diplomimit: viti kur keni kryer mësimet e shkollimit tuaj

Gjuha që dëshironi të jetë testi: në cilën gjuhë doni ta keni testin fizik

Pasi t’i plotësoni të gjitha fushat, klikoni në butonin

Apliko

Do ta pranoni një njoftim nga e-Kosova tek ikona , përmes telefonit (SMS) dhe e-mailit që tregon se keni aplikuar me sukses për provimin e maturës. Ky konfirmim nuk është përfundimtar pasi që aplikimin tuaj duhet ta konfirmoj edhe shkolla ku keni vijuar mësimet.

Pas konfirmimit nga ana e shkollës, do të pranoni edhe një njoftim i cili tregon se është paraqitur me sukses ose jo provimi i maturës shtetërore.

Nxënësi (maturanti), mesazhin e dytë të pranuar nga eKosova, përmes telefonit (SMS) dhe e-mail-it, duhet ta shtyp/printoj dhe ta ketë me vete në ditën e testimit. Pa këtë dokument nuk mund të hyni në provim, sepse aty do t'ju ndahet një **numër/kod unik** të cilin do ta plotësojë në fletëpërgjigje dhe njëkohësisht përmes atij kodi do të publikohen rezultatet individuale.

Sukses!